

KËRKESË
Nr. 1653, datë 30.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMEVE PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT
“M.S.S.C” DHE “QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **“M.S.S.C”**
- **“QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIM
Nr. 997, datë 1.2.2019
I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së Nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin Nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **Nr. 5, datë 17.10.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“M.S.S.C” shpk**, protokolluar me nr. 5664 prot., datë 24.10.2018,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me gërmën “a”, të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 5, datë 17.10.2018, në vlerën 30 000 lekë, dhe pezullimin plotësisht të aktivitetit deri në pajisjen me leje mjedisi dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

VENDIM

Nr. 886, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar, me vendimin nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **Nr. 000032-5, datë 25.10.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ**”, protokolluar me nr. 6636 prot., datë 26.11.2018,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/b/iii, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2007 “Për lejet e mjedisit”, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 000032-5, datë 25.10.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 30 000 lekë, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.